

Përmbledhje

- **Ekonomia e eurozonës, sipas Eurostat-it, ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 0.5 përqind në vitin 2023, ndërsa në tremujorin e fundit të vitit 2023 një rritje prej vetëm 0.1 përqind.** Kjo rritje është ndikuar nga normat ende të larta të interesit, inflacioni dhe dobësimi i eksportit. Projektionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE-ja janë 0.6 përqind për vitin 2024 dhe 1.5 përqind për vitin 2025. Shkalla e inflacionit në TM4 2023 ka arritur në 2.7 përqind, duke shënuar rënie të dukshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (9.9 përqind në TM4 2022). Projektionet e BQE-së sugjerojnë për një ngadalësim të inflacionit në 2.3 përqind në 2024 dhe 2.0 përqind në vitin 2025.
- **Ngjashëm me Eurozonën, edhe në Kosovë aktiviteti ekonomik në vitin 2023 vlerësohet të ketë shënuar rritje të ngadalësuar prej 3.3 përqind, ndërkohë që vetëm tremujori i fundit i vitit u karakterizua me një rritje të BPV-së prej 4.0 përqind.** Dinamikat në tremujorin e katërt të vitit 2023 i'u atribuan kryesisht zhvillimeve në komponentët e konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto kontribuan negativisht në rritjen reale të BPV-së. Konsumi rezultoi të ketë shënuar një rritje më të lartë, ndërsa rritja e investimeve u përcaktua kryesisht nga rritja e investimeve publike. Për vitin 2024, BQK parashikon një rritje më të lartë të aktivitetit ekonomik (3.9 përqind), e mbështetur nga investimet e përgjithshme, konsumi si dhe eksporti i shërbimeve. Parashikimet për rënie të eksportit të mallrave, si dhe rritja e importit të mallrave dhe shërbimeve pritet të ndikojnë negativisht aktivitetin e përgjithshëm ekonomik.
- **Inflacioni vazhdoi të ndjekë trend ngadalësimi përgjatë vitit 2023, me një normë mesatare prej 4.9 përqind. Ngadalësimi ishte më i theksuar në TM4 2023 (2.8 përqind),** kryesisht si rezultat i efektit të bazës, lehtësimeve në zinxhirët e furnizimit dhe çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Rritje e ngadalësuar u evidentua në një pjesë të madhe të komponentëve në shportën e konsumit, kurse çmimet e karburanteve dhe disa artikujve ushqimorë shënuan rënie. Edhe inflacioni bazë ndoqi ecuri rënëse, duke u ngadalësuar në 3.6 përqind në TM4 2023. Sipas projeksioneve të BQK-së, inflacioni pritet të vazhdojë trendin e ngadalësimit dhe të arrijë në 2.5 përqind në vitin 2024.
- **Buxheti i Kosovës në vitin 2023 shënoi bilanc pozitiv buxhetor, ndërsa në tremujorin e fundit është shënuar deficit.** Të hyrat buxhetore shënuan rritje vjetore prej 14.5 përqind në vitin 2023, me një normë të ngjashme të rritjes edhe në tremujorin e fundit të vitit. Edhe shpenzimet buxhetore shënuan rritje dyshifrore prej 13.2 përqind gjatë tërë vitit, ndërsa në tremujorin e fundit, shënuan rritje prej 10.0 përqind. **Borxhi publik u ul në 17.2 përqind të BPV-së, krahasuar me 19.9 përqind në fund të vitit 2022.** Përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë, si rezultat i rritjes së të hyrave dhe rritjes së BPV-së nominale, që zvogëlon raportin e borxhit ndaj BPV-së, kanë qenë faktorët kryesor që ndikuan në rënien e nivelit të borxhit publik.
- **Llogaria rrjedhëse në vitin 2023 u zvogëlua për 19.5 përqind, përderisa në TM4 2023, u karakterizua me rritje prej 3.3 përqind duke arritur vlerën prej 415.5 milionë euro.** Dinamikat në llogarinë rrjedhëse në TM4 2023 kanë vazhduar të përcaktohen kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave. Remitencat, si një ndër burimet më të rëndësishme të financimit të konsumit, shënuan rritje prej 5.0 përqind, duke arritur në 334.1 milionë euro. Ndërsa, investimet e huaja direkte shënuan rritje prej 86.6 përqind dhe arritën vlerën prej 223.0 milionë euro.
- **Sistemi financiar në vend ka vazhduar zgjerimin me ritëm të lartë edhe në tremujorin e fundit të vitit, duke mbyllur vitin me rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve, ndërkohë që zhvillimet në vitin vijues pritet të përcaktohen si nga dinamikat e përgjithshme makroekonomike ashtu edhe nga kapaciteti i ngritjes së fondeve - rritjes së depozitave dhe sigurimit të financimit nga jashtë.** Me përjashtim sektorin bankar i cili shënoi ngadalësim të shkallës së rritjes së aseteve, të gjithë sektorët tjerë u karakterizuan me rritje të përshpejtuar vjetore.
- **Sektori bankar** ndër vite ka siguruar nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit, dhe cilësi të lartë të aseteve - më konkretisht, nivel të ulët të kredive jo-performuese. Niveli i kapitalizimit përtej kërkesave rregullatore e bëri sektorin më të qëndrueshëm ndaj pasigurive të shkaktuara nga krizat gjeopolitike, inflacionit në rritje dhe aktivitetit më të ngadalësuar ekonomik. **Aktiviteti kreditues** kishte kontributin kryesor në rritjen e aseteve të sektorit bankar, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar se viti paraprak, pasuar nga **investimet në letrat me vlerë** që siguruan kthime më të larta përgjatë vitit në ambient me norma të rritura të interesit. Dinamikat në politikën monetare të BQE-së kanë ndikuar pjesërisht edhe në normat e interesit të aplikuara nga bankat vendore, meqenëse vendimi i fundit të shtator dhe sinjalizimi nga BQE për mos rritje të mëtejme të normave relevante rezultoi të jetë reflektuar në rënien e normave të interesit në kredi – ndërkohë që në normat e interesit në depozita vazhduan të ndjekin trend rritës. Asetet e **sektorit pensional** shënuan rritje të lartë në vitin 2023, pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë, ku të dy fondet pensionale shënuan kthim pozitiv nga investimet në tregjet e jashtme duke përfituar nga norma të larta të interesit. **Sektori i sigurimeve** u karakterizua me rritje dyshifrore në asete për vitin e pestë me radhë. Zgjerimi i sektorit buroi nga rritja e rezervave teknike, që janë rezultat i primeve të shkruara përgjatë vitit 2023, si dhe kapitalit vetanak të siguruesëve. Për më tepër, sektori në tri vitet e fundit ka realizuar performancë pozitive financiare, për dallim nga humbjet e krijuara në disa vite më parë. **Sektori mikrofinanciar** shënoi rritje të lartë të aktivitetit në vitin 2023, mbështetur kryesisht nga huamarrjet nga sektori i jashtëm për të financuar kreditimin dhe lizingjet. Sektori ka mbajtur nivel të ulët të kredive me probleme dhe ka realizuar nivel të lartë të profitabilitetit.

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Bujqësi dhe Ushqim)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KJF	Korporatat jo-financiare
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook

Përmbajtja

Përmbledhje	i
Lista e shkurtesave	1
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	3
3. Ekonomia e Kosovës	6
3.1. Rritja Ekonomike	6
3.2. Çmimet	7
3.3. Sektori Fiskal	9
3.4. Sektori i jashtëm	10
4. Sistemi financiar	14
4.1. Sektori bankar	14
4.2. Sektori pensional	23
4.3. Sektori i sigurimeve	24
4.4. Sektori mikrofinanciar	25
4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës	29

1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e Eurozonës, sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat, shënojë rritje vjetore prej vetëm 0.5 përqind gjatë vitit 2023, e ndikuar nga normat e larta të interesit që frenuan konsumin dhe investimet, ndikimi i çmimeve në tendencat e konsumit si dhe dobësimi i eksportit si pasojë e ngadalësimit të ekonomisë globale. **Në TM4 2023, rritja reale e BPV-së në ekonominë e Eurozonës mbeti e pa ndryshuar, duke stagnuar kundrejt tremujorit paraprak, ndërsa shënoi rritje prej 0.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.** Komponentët kryesor që ndikuan në rritjen ekonomike të Eurozonës në TM4 2023 ishin konsumi final i qeverisë prej 0.1 pikë përqind dhe formimi i bruto kapitalit prej 0.2 pikë përqind, ndërsa eksporti neto kontribuoi negativisht me 0.3 pikë përqind. **Projeksionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE janë rishikuar në mars 2024 kundrejt projeksioneve të dhjetorit 2023, në 0.6 përqind për vitin 2024 dhe 1.5 përqind për vitin 2025.** Konsumi privat pritet të jetë shtytësi kryesor i rritjes ekonomike, duke i'u atribuar rënies së inflacionit dhe rritjes së të ardhurave reale. Për më tepër, rënia e pasigurisë dhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve pritet të japin mbështetje shtesë për konsumin privat.

Shkalla e inflacionit në TM4 2023 ka arritur në 2.7 përqind, duke shënuar rënie të dukshme kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar (9.9 përqind në TM4 2022). Projeksionet e BQE-së sugjerojnë një ngadalësim të inflacionit në 2.3 përqind në 2024 dhe 2.0 përqind në vitin 2025. Megjithatë, dinamikat e inflacionit mund të ndikohen përgjatë viteve projektuese me përkeqësimin e mëtejshëm të tensioneve aktuale gjeopolitike, veçanërisht në Lindjen e Mesme, duke u reflektuar në çmimet potenciale të energjisë dhe kostot e mallrave. Në takimin e BQE-së të mbajtur në mars 2024, normat e interesit u mbajtën të pandryshuara, me normën e interesit në depozita në 4.0 përqind, normën në operacionet e ri financimit në 4.5 përqind dhe normën margjinale për huadhënie në 4.7 përqind. Normat ende të larta të interesit pritet të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike në muajt e ardhshëm, duke sjellë presion mbi BQE-në për të shqyrtuar mundësinë e uljes së normave kyçe të interesit gjatë vitit 2024.

Projeksionet e FMN-së, të realizuara në prill 2024, sugjerojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje mesatare ekonomike prej 3.0 përqind në vitin 2023 dhe pritet të shënojnë një rritje prej 3.2 përqind në 2024. Rritja ekonomike pritet të ndikohet nga presionet e jashtme, duke përfshirë ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë, si dhe nga efektet e brendshme si përballja me inflacionin dhe rritja e kostos së financimit. Shkalla mesatare e inflacionit në TM4 2023 rezulton të ketë qenë 4.4 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Serbi prej 8.0 përqind, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina rezulton të ketë shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 2.0 përqind.

Në TM4 2023, tregu i këmbimit valutor i euros kundrejt valutave të partnerëve tregtar u vlerësua në krahasim me lirën turke dhe sterlinën britaneze kundrejt tremujorit paraprak. Vlera e valutës euro u zhvlerësua kundrejt lekut shqiptar, dollarit amerikan dhe frangut zviceran, ndërsa mbeti pothuajse e njëjtë ndaj denarit maqedonas.

2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare


Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare vazhduan të ulen në TM4 2023 si rezultat i ngadalësimit të kërkesës globale dhe pas mosrealizimit të shqetësimeve për rritjen e çmimeve si pasojë e konfliktit në Lindjen e Mesme. Indeksi i çmimeve të mallrave bazë sipas Bankës Botërore shënoi rënie kundrejt tremujorit paraprak bazuar në rënien e çmimit të naftës, disa mallrave ushqimore dhe metaleve. Gjithashtu, u evidentuan prirje ngritëse në çmimet e mallrave tjera, pjesërisht si pasojë e pengesave në ofertë të artikujve tjerë ushqimorë dhe gazit natyror, si dhe rritjes së kërkesës për disa metale në Kinë. Çmimet e mallrave bazë parashihet të vazhdojnë lehtësimin përgjatë vitit 2024, bazuar në parashikimet për ngadalësimin e aktivitetit ekonomik global dhe ndikimin e limituar të tensioneve gjeopolitike. Megjithatë, rreziqet ndaj këtyre pritjeve përfshijnë ndër të tjera kufizimet potenciale tregtare dhe ndikimin e kushteve klimatike në çmimet e mallrave ushqimore.

Në TM4 2023, çmimet e naftës së papërpunuar brent sipas Bankës Botërore ishin \$84.0 për fuçi, duke shënuar rënie prej 4.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 1). Kjo ndikoi që viti 2023 të përmbyllet me çmim mesatar vjetor prej \$82.6 për fuçi.

Përkundër reduktimit të ofertës globale të naftës nga OPEC dhe vendet tjera eksportuese, çmimet e naftës brent shënuan rënie prej 3.1 përqind në raport me tremujorin paraprak (\$86.8 për fuçi në TM3 2023). Kjo rënie ishte kryesisht rezultat i shqetësimeve lidhur me ngadalësimin e rritjes ekonomike globale. Mesatarja vjetore e çmimeve të naftës për vitin 2024, bazuar në projeksionet e Bankës Botërore, parashihet të jetë rreth \$84 për fuçi. Sidoqoftë, ky parashikim shoqërohet me rreziqe si përkeqësimi i tensioneve gjeopolitike të intensifikuara me konfliktin në Lindjen e Mesme dhe turrja e mëtejshme potenciale e ofertës së naftës nga vendet eksportuese. Ndërsa, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik global pritet të reflektohet në ngadalësim të çmimeve të naftës.


Çmimet e gazit natyror në Evropë në TM4 2023 arritën \$13.5/mmmbtu, duke rezultuar kështu në rënie vjetore prej 63.4 përqind kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak kur çmimet vazhdonin të ishin të larta si pasojë e pengesave në furnizim nga Rusia (grafiku 1). Në anën tjetër, kundrejt tremujorit paraprak, çmimet e gazit natyror në Evropë shënuan rritje prej 25.6 përqind, me rritje më të theksuar në tetor dhe nëntor. Kjo rritje u shkaktua nga grevat në industrinë e gazit në Australi, konflikti në Lindjen e Mesme, pengesat në tregun global pas mbylljes së fushës së gazit Tamar në Izrael, si dhe pas shpërthimit në gazsjellësin në detin Baltik. Megjithatë, rezervat e mjaftueshme në Evropë, importi i LNG (gazit natyror të lëngshëm), si dhe kushtet e lehta klimatike, relativisht zbutën presionet inflacioniste, me çmimet që ranë në \$11.5/mmmbtu në dhjetor 2023. Çmimet e gazit natyror në Evropë pritet të shënojnë mesatare vjetore prej \$9.5/mmmbtu në 2024 bazuar në rezervat pothuajse të plota në Evropë, rënies së kërkesës së gazit për qëllime industriale dhe për ngrohje, si dhe mbi supozimin e kufizimit të konfliktit në Lindjen e Mesme.

Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve shënoi rënie prej 0.1 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në ekonomitë e mëdha, krahas stabilizimit të ofertës së metaleve përgjatë vitit. Rënie u evidentua në çmimet e nikelit dhe bakrit bazuar në rritjen e prodhimit, ndërsa çmimet e aluminit, zinkut, dhe xehes së hekurit shënuan ngritje si rrjedhojë e përmirësimit të sentimentit në Kinë dhe kufizimeve në ofertë. Ngjashëm, indeksi i çmimeve të metaleve shënoi rënie vjetore prej 0.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Çmimet e metaleve pritet të mbesin pothuajse të pandryshuara përgjatë vitit 2024, mirëpo perspektiva shoqërohet nga rreziqe që mund të ndikojnë në kërkesën për metale si aktiviteti ekonomik global, veçanërisht në Kinë, si dhe kufizimet tregtare dhe tensionet gjeopolitike. Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara ishte 13.2 përqind më i lartë në TM4 2023 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rritje u evidentua edhe në raport me tremujorin paraprak, kur ky indeks u ngrit për 1.8 përqind si rezultat i rritjes së çmimit të arit prej 2.4 përqind me fillimin e konfliktit në Lindjen e Mesme, që rriti kërkesën për ari si aset për shmangie të rrezikut. Ndërsa, çmimet e platinit dhe argjendit shënuan rënie prej 2.3 përkatësisht 1.5 përqind kundrejt tremujorit paraprak.


Grafik 2. Çmimet e metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Burimi: Banka Botërore.

Indeksi i çmimeve të ushqimit në TM4 2023, sipas FAO-s¹, shënoi rënie prej 2.0 përqind krahasuar me tremujorin paraprak. Të gjitha kategoritë shënuan rënie, përveç produkteve të bulmetit, të cilat shënuan rritje prej 1.3 përqind dhe vazhduan të ndjekin prirje rritëse, ndikuar ndër tjera edhe nga rritja e kërkesës në prag të festave të fund vitit (grafik 3). Rënia e çmimeve të ushqimit u ndikua kryesisht nga rritja e rendimentit dhe kërkesa më e ulët nga vendet importuese. Megjithatë, dinamikat përgjatë tremujorit ishin të luhatshme sa u përket drithërave, vajrave dhe sheqerit, si rezultat i luhatjeve në kërkesë për vajra, shqetësimeve rreth sigurisë së furnizimit me sheqer për shkak të kushteve klimatike, dhe problemeve logjistike në ofertën e drithërave. Në raport me TM4 2022, çmimet e ushqimit rezultuan në rënie vjetore prej 11.1 përqind nxitur nga rënia e dukshme e çmimeve të bulmetit (-21.4 përqind), vajrave (-18.7 përqind), drithërave (-18.0 përqind) dhe mishit (-2.2 përqind), ndërsa çmimet e sheqerit shënuan rritje vjetore prej 33.7 përqind. Lehtësimet në çmimet e ushqimit pritet të vazhdojnë edhe përgjatë vitit 2024, bazuar në pritjet për rritje të rendimentit dhe për një ofertë të qëndrueshme.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAO.

¹ Food and Agricultural Organization of the United Nations (FAO) Food Price Index - Indeksi i Çmimeve të Ushqimit i Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë i Kombeve të Bashkuara.


3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Rritja Ekonomike

Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve tremujore të ASK-së, ka shënuar një rritje të ngadalësuar prej 3.3 përqind në vitin 2023.

Në TM4 2023, aktiviteti ekonomik vlerësohet të ketë shënuar rritje reale prej 4.0 përqind, një rritje më e lartë krahasuar me tremujorët paraprak të vitit 2023, por më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Rritja më e ngadalësuar e aktivitetit ekonomik krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak mund t'i atribuohet kryesisht dinamikës në eksporte, e që vlerësohet të jetë ndikuar nga dinamika e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe efekteve që kanë në eksportet e mallrave si metalet, mineralet dhe plastika, kërkesës së dobësuar në eurozonë dhe performancës së dobësuar të një prodhuesi. **Rritja e gjeneruar e aktivitetit ekonomik në TM4 2023** i është atribuuar kontributit pozitiv të konsumit dhe investimeve prej 8.3 përkatësisht 0.9 pikë përqindje. Në anën tjetër, eksportet neto patën një ndikim negativ në rritjen reale të BPV-së me 5.3 pikë përqindje (grafiku 4).

Grafik 4. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit




Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Konsumi shënoi rritje prej 8.2 përqind në TM4 2023, që është një rritje më e lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, e që mund t'i atribuohet rritjes së burimeve kryesore të financimit dhe përmirësimit të besimit të konsumatorëve nën dinamikën e dobësimit të presioneve inflacioniste. Investimet shënuan rritje për 2.5 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së investimeve publike si dhe investimeve të huaja direkte. Sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto thelluan deficitin tregtar për 13.9 përqind në TM4 2023. Rritja e deficitit tregtar ishte si rezultat i rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve për 10.8 përqind (importi i mallrave shënoi rritje për 8.0 përqind, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje për 26.1 përqind), si dhe rënies së eksportit të mallrave për 5.8 përqind, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje për 12.9 përqind.

Rritja e aktivitetit ekonomik në TM4 2023 është mbështetur kryesisht nga rritja e vlerës së shtuar në sektorin e aktiviteteve administrative dhe mbështetëse (6.8 përqind), hoteleve dhe restoranteve (2.8 përqind), industrisë përpunuese (2.7 përqind), industrisë nxjerrëse (2.6 përqind), tregtisë (2.1 përqind), etj. Të dhënat e qarkullimit të bizneseve konfirmojnë këtë rritje, ku qarkullimi në sektorin e shërbimeve administrative dhe mbështetëse ka shënuar rritje prej 66.6 përqind, në sektorin e industrisë nxjerrëse 2.4 përqind, etj. Sektori i tregtisë ka shënuar një rritje të dukshme prej 7.4 përqind.

Grafik 5. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.

Aktiviteti ekonomik u reflektua në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, duke arritur në 2,821 ndërmarrje të reja në TM4 2023, një rritje prej 7.0 përqind krahasuar me TM4 2022. Sektori i tregtisë, sektori i aktiviteteve profesionale, prodhimit, hotelierisë, etj., shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të


regjistruara. Këta sektorë treguan një rritje të ndjeshme në numrin e ndërmarrjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (grafiku 5). Në anën tjetër, gjatë TM4 2023, u mbyllën 397 ndërmarrje, ose 13.1 përqind më pak krahasuar me TM4 2022.

Projeksionet e BQK-së për vitin 2024 sugjerojnë për një rritje ekonomike prej 3.9 përqind si rezultat i rritjes së të ardhurave reale të disponueshme, për shkak të rënies së inflacionit dhe rritjes së burimeve të tjera të financimit. Megjithatë, në TM1 2024 vlerësohet se është shënuar ngadalësim i rritjes (3.3 përqind), si pasojë e vlerësimeve për rënie të eksportit të mallrave si dhe rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve, përdërisa investimet e përgjithshme, konsumi, si dhe eksporti i shërbimeve, vlerësohet se ndikuan pozitivisht rritjen e BPV-së.

3.2. Çmimet

Inflacioni vazhdoi të ndjekë trend ngadalësimi përgjatë vitit 2023, duke u mbyllur viti me një normë mesatare prej 4.9 përqind kundrejt 11.6 përqind sa ishte në vitin 2022. Ngadalësimi ishte më i theksuar në TM4 2023, ku shkalla e inflacionit arriti në 2.8 përqind, nga 3.2 përqind sa ishte në tremujorin paraprak. Faktorët që ndikuan në këtë ngadalësim ishin baza e lartë e një viti më parë si dhe lehtësimi i çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Ngadalësimi i inflacionit pasqyron rritjen e ngadalësuar të çmimeve të ushqimit, rënien e çmimeve të karburanteve dhe zbutjen e presioneve inflacioniste në shërbime, ndërsa kontributi nga çmimet e mallrave tjera mbeti pothuajse i pandryshuar (grafiku 6).

Grafiku 6. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.


Çmimet e ushqimit shënuan rritje vjetore prej 3.0 përqind në TM4 2023, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 5.5 përqind në tremujorin paraprak. Ngadalësim u evidentua në pothuajse të gjitha kategoritë e ushqimit me përjashtim të çmimeve të peshkut, frutave, dhe vajrave. Megjithatë, rritja vjetore vazhdoi të mbetet ende e lartë në çmimet e perimeve dhe frutave (16.1 respektivisht 16.0 përqind në TM4 2023), peshkut (8.7 përqind), sheqerit dhe produkteve të tij (7.1 përqind) si dhe prodhimeve ushqimore (6.9 përqind). Ndërsa, çmimet e qumështit, djathit, dhe vezëve shënuan rënie prej 2.8 përqind, kurse çmimet e vajrave shënuan rënie prej 10.7 përqind. Përkundër rënies/ngadalësimit në disa artikuj ushqimorë, çmimet e ushqimit mbeten pothuajse 30 përqind mbi nivelet e tyre para luftës në Ukrainë, duke vazhduar të rëndojnë mbi të ardhurat e disponueshme të ekonomive familjare, marrë parasysh peshën e ushqimit në shportën e konsumit në vend (32.2 përqind).

Çmimet e transportit shënuan rënie vjetore prej 1.5 përqind në TM4 2023 me nënkategorinë e përdorimit të pajisjeve për transport personal që regjistroi rënie vjetore prej 5.8 përqind si rrjedhojë e efektit të bazës dhe rënies së çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare krahasuar me vitin e kaluar. Për më shumë, ngritja e çmimeve të karburanteve e regjistruar në tremujorin paraprak rezultoi e njehershme pasi, në linjë me ecurinë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, çmimet e karburanteve në vend u ngadalësuan përgjatë tremujorit të fundit të vitit.

Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM4 2023 ishte 1.0 pikë përqindje (nga 2.0 pikë përqindje në TM3 2023), me kontributin më të lartë të shënuar nga rritja e çmimeve të perimeve, bukës dhe drithërave, frutave, mishit, e të tjera. Ndërsa, kontributi i energjisë në inflacionin e përgjithshëm në TM4 2023 arriti në -0.2 pikë përqindje, i përcaktuar kryesisht nga karburantet. Kontributi i çmimeve të mallrave tjera jo energjetike shënoi rënie të lehtë në 1.0 pikë përqindje në TM4 2023 bazuar në ngadalësimin e çmimeve të mallrave të ndryshme, në veçanti atyre të automjeteve. Kurse, kontributi i shërbimeve në gjithsej IÇK-në u zvogëlua në 0.7 pikë përqindje (nga 0.8 pikë përqindje në TM3 2023) falë ngadalësimit të çmimeve të shërbimeve të transportit dhe atyre për mirëmbajtjen e zakonshme të shtëpisë.

Inflacioni bazë në TM4 2023 shënoi rritje vjetore prej 3.6 përqind, që kundrejt tremujorit paraprak paraqet ngadalësim prej 0.2 pikë përqindje si rezultat i ngadalësimit të presioneve inflacioniste në shërbimet e transportit, atyre hoteliere, si dhe ngadalësimit të çmimeve të orendive, pajisjeve shtëpiake dhe mirëmbajtjes së shtëpisë (grafiku 7). Ndërsa, rritje u evidentua në çmimet e shërbimeve të rekreacionit dhe kulturës, veshmbathjes, dhe shërbimeve ambulatore.


Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe pjesëmarrja e lartë e këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që shkalla e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në TM4 2023, 2.0 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 0.8 pikë përqindje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (grafiku 8).

Grafik 8. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) shënoi rritje vjetore prej 1.0 përqind në TM4 2023, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 3.0 përqind në tremujorin paraprak. Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kategoritë me peshën më të lartë në kuadër të këtij indeksi që përfshijnë: i) artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhanin, dhe ii) pajisjet e makinerisë dhe ato elektrike, që shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind dhe 0.6 përqind respektivisht, ndërsa iii) metalet bazë dhe artikujt përkatës, dhe iv) produktet minerale shënuan rënie vjetore prej 5.3 respektivisht 7.4 përqind. Në raport me tremujorin paraprak, IÇIMP shënoi rënie prej 1.0 përqind kryesisht si rezultat i rënies së çmimit në të katër kategoritë kryesore të lartpërmendura, mbështetur po ashtu nga ngadalësimi në kategori tjera.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi në rritje prej 2.7 përqind në TM4 2023 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimit të prodhimit të energjisë elektrike (1.2 përqind). Kategoritë tjera me peshë të konsiderueshme në IÇP, si prodhimi i mineraleve jometalike (3.2 përqind rritje vjetore), përpunimi i produkteve ushqimore (6.4 përqind), prodhimi i pijeve (4.5 përqind), dhe gomës dhe plastikës dhe produkteve përkatëse (1.6 përqind), gjithashtu kontribuan në këtë rritje.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) në TM4 2023 shënoi rënie vjetore prej 0.3 përqind. Kjo rënie u ndikua kryesisht nga rënia e çmimeve të materialeve ndërtimore (-1.7 përqind) dhe transportit (-8.1 përqind). Ndërsa,

u evidentuan presione inflacioniste të pagave në sektorin e ndërtimit, si dhe rritje e çmimeve të energjisë, makinerive dhe kostove tjera. Në raport me TM3 2023, u evidentua rritje e IKN prej 0.7 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së pagave dhe çmimeve të energjisë; ndërsa u evidentua rënie e lehtë në çmimet e materialeve ndërtimore.

Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në vitin 2024 të ngadalësohet në 2.5 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë stabilizimin e ofertës dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare krahas ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global, trendin zbritës të inflacionit në eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, e të tjera. Rreziqet e ndërlidhura me inflacionin anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa në zinxhirët e furnizimit si pasojë e tensioneve gjeopolitike, reduktimin e sasisë së prodhimit nga OPEC+, ndikimin e migrimit potencial në paga pas liberalizimit të vizave, e të tjera.


3.3 Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore në vitin 2023 arritën vlerën neto prej 2.85 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.5 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, normës ende të lartë të inflacionit, si dhe përpjekjeve për formalizimin e ekonomisë. Edhe shpenzimet buxhetore shënuan rritje dyshifrore prej 13.2 përqind dhe arritën vlerën prej 2.84 miliardë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 14.6 milionë euro. **Sa i përket TM4 2023, të hyrat primare buxhetore² vetëm në këtë tremujor arritën vlerën neto 737.4 milionë euro, duke paraqitur një rritje vjetore prej 15.0 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet primare buxhetore³ shënuan rritje prej 10.0 përqind dhe arritën vlerën 1.04 miliardë euro. Si rezultat i nivelit më të lartë të shpenzimeve buxhetore, vetëm në TM4 2023, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 304.7 milionë euro.**

Të hyrat tatimore në TM4 2023 arritën vlerën 666.6 milionë euro, duke shënuar rritje prej 16.2 përqind krahasuar me TM4 2022. Gjatë kësaj periudhe, pothuajse të gjitha kategoritë e tatimeve shënuan rritje. Rritja më e lartë u evidentua tek të hyrat tatimore indirekte të cilat përbënin rreth 77 përqind të gjithë të hyrave buxhetore në TM4 2023. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 15.7 përqind, duke arritur vlerën 570.2 milionë euro. Rritja e të hyrave tatimore indirekte, ndër tjera kishte të bënte edhe me normën e lartë të inflacionit, e cila edhe pse është ulur ndjeshëm vazhdon të mbetet e lartë. Në kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat

nga TVSH-ja dhe detyrimi doganor shënuan rritje prej 16.2 përkatësisht 23.0 përqind, duke u ndikuar dukshëm nga rritja e çmimeve. Edhe tatimi i akcizës shënoi rritje të lartë prej 12.4 përqind, si rezultat i përshpejtimit të rritjes së importit të mallrave në TM4 2023 (grafiku 9). Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 14.2 përqind dhe arritën vlerën 114.2 milionë euro. Rritja e të hyrave tatimore direkte që kryesisht realizohen nga Administrata Tatimore e Kosovës, ishte rezultat i përmirësimit të procesit të mbledhjes së të hyrave, aktiviteteve të ndërmarra për luftimin dhe parandalimin e evazionit tatimor dhe forcimit të përmbushjes vullnetare nga ana e tatimpaguesve. Brenda kësaj kategorie, tatimi në të ardhurat personale, si kategoria

Grafik 9. Struktura e të hyrave tatimore



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

kryesore, shënoi rritje vjetore prej 17.0 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 15.4 përqind.

Përveç të hyrave tatimore, edhe të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 3.4 përqind dhe arritën vlerën 67.5 milionë euro. Në këtë kategori, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 38.1 milionë euro duke shënuar rritje prej 4.9 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rënie për 2.4 përqind dhe arritën vlerën 16.8 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje për 9.3 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rritje për 11.5 përqind. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet për paga shënuan rritje prej 14.5 përqind dhe arritën vlerën 200.4 milionë euro, shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 18.3 përqind dhe arritën vlerën 166.7 milionë euro, ndërsa shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan rritje prej 3.4 përqind dhe arritën vlerën 378.1 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 11.5 përqind duke arritur vlerën 291.3 milionë euro.


Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u ul në 17.2 përqind në TM4 2023, krahasuar me 19.9 përqind në TM4 2022. Kjo ulje e raportit të borxhit publik ndaj BPV-së rezultoi nga përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë në vitin 2023 dhe rritja e BPV-së nominale. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.66 miliardë euro në TM4 2023, duke shënuar rënie prej 5.1 përqind krahasuar me TM4 2022. Zvogëlimi i borxhit publik ishte rezultat i uljes së borxhit të brendshëm publik për 12.8 përqind, duke arritur në 970.2 milionë euro, ndërsa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 8.1 përqind dhe arriti në 692.9 milionë euro.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (36 përqind), Bashkimit Evropian (14 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (13 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (11 përqind), etj. Në anën tjetër, borxhi i brendshëm përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (46 përqind), bankave komerciale (24 përqind), institucioneve publike (22 përqind), etj.

3.4. Sektori i jashtëm

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2023 u zvogëlua për 19.5 përqind, duke shënuar vlerën prej 738.4 milionë euro (917.1 milionë euro në vitin 2022). Vetëm në TM4 2023, deficiti i llogarisë rrjedhëse ishte 415.5 milionë euro (402.3 milionë euro në TM4 2022). Bilanci i llogarisë rrjedhëse në TM4 2023 ka vazhduar të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave, komponentë e cila u përkeqësua si pasojë e rritjes së importit të mallrave dhe rënies së eksportit. Ndërkaq, të ardhurat parësore, të ardhurat dytësore dhe shërbimet kontribuan në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse (grafiku 10).

Grafik 10. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Kategoria e mallrave në TM4 2023 shënoi rritje vjetore të deficitit prej 15.1 përqind, duke arritur vlerën prej 1.4 miliardë euro (grafiku 11). Arsyeja kryesore e rritjes së deficitit tregtar ndërlidhet me vlerën e lartë të importit të mallrave dhe rënien e eksportit. Eksporti i mallrave në TM4 2023 mbuloi vetëm 13.4 përqind të importeve, respektivisht 1:7.5 raporti tregtar.


Eksporti i mallrave në vitin 2023 shënoi rënie vjetore prej 6.2 përqind, duke shënuar vlerën prej 863.1 milionë euro (920.4 milionë euro në vitin 2022). Vetëm në TM4 2023, vlera e përgjithshme e eksportit të mallrave ishte 222.3 milionë euro, një rënie prej 4.3 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Struktura e mallrave sipas kategorive mbetet kryesisht e pa ndryshuar. Eksporti i metaleve bazë ka shënuar rritje prej 8.1 përqind në TM4 2023, duke arritur vlerën prej 47.4 milionë euro nga 43.9 milionë euro sa ishte në TM4 2022. Ndërkohë, në rënien e eksportit të mallrave ndikuan kryesisht rënia e eksportit në tregun e SHBA-së për 5.9 përqind si dhe produktet e plastikës dhe gomës, të cilat shënuan rënie për 4.6 përqind (grafik 12). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në TM4 2023 ishin shtetet e Ballkanit Perëndimor me një pjesëmarrje prej 39.0 përqind të gjithsej mallrave të eksportuara dhe vendet BE-së me një pjesëmarrje prej 33.7 përqind, ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania, me 10.8 përqind të gjithsej eksporteve kosovare.

Mallrat e importuara në vitin 2023 arritën vlerën prej 5.9 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 4.9 përqind. Ndërkaq, vlera e importit të mallrave vetëm në TM4 2023 arriti në 1.6 miliardë euro, një rritje vjetore prej 12.0 përqind. Struktura e mallrave të importuara vazhdon të dominohet nga importi i produkteve minerale, artikujt ushqimorë dhe makineritë, përfshirë pajisjet shtëpiake (grafik 13). Importi sipas kategorive kryesore u dominua nga mallrat e ndërmjetme, me 44.0 përqind, mallrat konsumuese, me 30.8 përqind, ndërsa kategoria e mallrave kapitale mbetet e ulët, me 10.2 përqind të importit të përgjithshëm. Dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ndikuan në rritjen e sasisë së mallrave të importuara, veçanërisht në kategorinë e mallrave kapitale dhe mallrave konsumuese, të cilat shënuan rritje të importit prej 11.9 dhe 11.2 përqind. Struktura e partnerëve tregtar mbeti e pa ndryshuar, me Bashkimin Evropian që kryeson me rreth 43.1 përqind të importeve, ku Gjermania me vazhdon ta ketë peshën kryesore prej 13.0 përqind të gjithsej importeve kosovare. Nga vendet e rajonit, Kosova importoi 13.6 përqind të importit të përgjithshëm apo 226.2 milionë euro. Ndërkohë, importi i mallrave nga Turqia arriti vlerën prej 293.2 milionë euro apo 17.6 përqind të vlerës së përgjithshme të importeve.


Grafik 11. Bilanci tregtar i mallrave



Grafik 12. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Grafik 13. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro




Shërbimet kanë vazhduar të kontribuojnë pozitivisht në kuadër të llogarisë rrjedhëse, duke shënuar rritje vjetore të bilancit pozitiv prej 7.3 përqind dhe duke arritur vlerën prej 230.5 milionë euro në TM4 2023 (grafik 14). Eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 17.7 përqind dhe arriti vlerën prej 546.2 milionë euro. Rritja e eksportit të shërbimeve ishte kryesisht rezultat i rritjes së shërbimeve të udhëtimit prej 19.0 përqind, kategori që arriti vlerën prej 331.7 milionë euro, ndikuar kryesisht nga rritja e numrit të udhëtarëve për 15.8 përqind kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në rritjen e eksportit të shërbimeve kontribuoi edhe kategoria e shërbimeve të teknologjisë informative, që shënoi rritje prej 41.0 përqind dhe arriti vlerën prej 82.1 milionë euro nga 58.2 milionë euro sa ishte në TM4 2022. Në anën tjetër, importi i shërbimeve ka arritur vlerën prej 315.7 milionë euro, një rritje vjetore prej 26.8 përqind. Rritja e importit të shërbimeve i'u atribua rritjes së shërbimeve të udhëtimit dhe transportit, të cilat përbejnë 58.4 përqind të vlerës së përgjithshme të importit të shërbimeve. Pas liberalizmit të vizave që nisi nga janari i vitit 2024, importi i shërbimeve të udhëtimit pritet të ndikohet, dinamikë që mund të dobësoj bilancin e shërbimeve.

Bilanci i të ardhurave parësore ka arritur në 92.0 milionë euro në TM4 2023 (54.5 milionë euro në TM4 2022). Rritja e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga të ardhurat e kompensimit të punëtorëve, bilanci i të cilave arriti vlerën prej 94.3 milionë euro, një rritje prej 41.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, bilanci i të ardhurave nga investimet ishte negativ prej 2.3 milionë euro në TM4 2023, si pasojë e kthimit të dividendës nga investimet e huaja direkte (grafiku 15). Ndërkaq, investimet portfolio shënuan bilanc pozitiv prej 18.1 milionë euro, ndikuar kryesisht nga letrat me vlerë, e ndjekur nga investimet tjera me bilanc negativ prej 2.9 milionë euro dhe asetet rezervë me bilanc pozitiv prej 13.8 milionë euro.


Vlera e remitencave të pranuar në vitin 2023 ka arritur në 1.3 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 9.9 përqind krahasuar me vitin paraprak. Vlera e remitencave të pranuar vetëm në TM4 2023 ka arritur në 334.1 milionë euro, një rritje prej 5.0 përqind krahasuar me TM4 2022 (grafiku 16). Remitencat vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, që përbëjnë rreth 59.2 përqind të gjithsej remitencave. Remitencat sipas kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë

Grafik 14. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

Grafik 15. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.

Grafik 16. Remitencat




Burimi: BQK.

shënuar rritje prej 2.2 përqind, ndërsa është shënuar rritje prej 13.1 përqind e dërgesave përmes kanaleve të tjera.


Investimet e huaja direkte në vitin 2023 arritën vlerën prej 844.3 milionë euro, duke shënuar 15.3 përqind rritje vjetore në krahasim me 732.0 milionë euro sa ishin në vitin 2022. Investimet e huaja direkte në TM4 2023 rezultojnë të kenë shënuar rritje prej 86.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën prej 223.0 milionë euro (grafiku 17). Rritja e IHD-ve është evidentuar kryesisht në sektorin e patundshmërisë, me një rritje prej 6.0 përqind, duke arritur vlerën prej 142.4 milionë euro në krahasim me 134.3 milionë euro sa ishte në TM4 2022. Megjithëse sektori i patundshmërisë mbetet sektori kryesor për IHD-të, në TM4 2023 është vërejtur rritje e lehtë e IHD-ve në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe sektorin e xehetarisë përfshirë gurorët (grafik 18). Investimet direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rënie prej 48.0 përqind në TM4 2023, duke arritur vlerën prej vetëm 28.1 milionë euro në krahasim me 53.9 milionë euro sa ishte në TM4 2022, investime të destinuara kryesisht në vendet e rajonit e të orientuara në sektorin e patundshmërisë.

Grafik 17. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Grafik 18. IHD-të sipas aktiviteve kryesore



Burimi: BQK.


4. Sistemi financiar

Sistemi financiar në vend ka vazhduar zgjerimin me ritëm të lartë edhe në tremujorin e fundit të vitit, duke mbyllur vitin me rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve, ndërkohë që zhvillimet në vitin vijues pritet të jenë subjekt i dinamikave të përgjithshme makroekonomike që pritet të jenë më pozitive, si dhe kapacitetit të ngritjes së fondeve - rritjes së depozitave dhe sigurimit të financimit nga jashtë.

Në dhjetor 2023, asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 11.1 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.4 përqind (grafiku 19). Me përjashtim sektorin bankar i cili shënoi ngadalësim të shkallës së rritjes së aseteve, të gjithë sektorët tjerë u karakterizuan me rritje të përshpejtuar vjetore.

Sektori bankar në dhjetor 2023 përfaqësoi 67.9 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar, dhe për shkak të peshës së lartë në sistem dha kontributin kryesor në zgjerimin e tij përkundër rritjes vjetore më të ngadalshme (grafiku 20). Fondet pensionale, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, shënuan rritje të përshpejtuar të aseteve krahasuar me një vit më parë. Sektorët tjerë, si ai mikrofinanciar, i sigurimeve dhe ndihmësve financiar shënuan poashtu rritje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe, por për shkak të peshës së ulët, kishin kontribut të ulët në rritjen e gjithëj aseteve të sistemit financiar.


Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



4.1. Sektori bankar

Sektori bankar përgjatë vitit 2023 ishte i ekspozuar ndaj rreziqeve që buruan nga faktorët e përkeqësuar makroekonomik, të ndikuar nga situata gjeopolitike si dhe efektet e akumuluar të inflacionit. Efektet nga politikat e shtrënguara monetare ndikuan në uljen e nivelit të inflacionit në eurozonë dhe më gjerë, duke u reflektuar në rënien e presioneve inflacioniste edhe në Kosovë. Sidoqoftë, inflacioni më i lartë për një periudhë më të gjatë kohore prodhoi pasoja negative në segmente tjera të ekonomisë, përkatësisht efekt negativ në shportën e konsumit, rritje të normave të interesit në kredi në gjysmën e parë të vitit 2023 me tendencë stabilizuese në gjysmën e dytë të vitit, rritje të çmimeve në patundshmëri, si dhe presion për paga në tregun e punës. Në vitin vijues, pritet që presionet inflacioniste të zbuten tutje, duke zvogëluar pasiguritë për investime të cilat presin të japin kontribut në rritjen e përgjithshme ekonomike. Sektori bankar në Kosovë për shkak të peshës, strukturës dhe kompleksitetit të ulët, nuk ka ekspozim të lartë me sektorin e jashtëm. Sidoqoftë, efektet negative që burojnë nga dinamikat makroekonomike si rritja ekonomike në Eurozonë, shkalla e inflacionit dhe rritja e kostos së financimit kanë ndikim më të drejtpërdrejtë në kërkesën e brendshme në Kosovë dhe për pasojë, implikime në dinamikat në sektor bankar.

Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Asetet


Në dhjetor 2023, asetet e sektorit bankar arritën vlerën 7.5 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.6 përqind, për 1.9 pikë përqindje më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 21). Kjo dinamikë u ndikua nga aktiviteti kreditues - si aktiviteti kryesor i sektorit bankar - i cili u rrit me ritëm më të ngadalësuar se viti paraprak. Ambienti i normave më të larta të interesit ndikoi që zëri i investimeve në letrat me vlerë të rritet me ritëm më të shpejtë, ndërsa zërat me kthim më të ulët si bilanci në bankat tjera dhe zëri i parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në shënuan ngadalësim të rritjes.

Kreditimi

Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 13.0 përqind, që përkon me shkallë më të ulët të rritjes vjetore prej 3 pikë përqindje. Ky zhvillim reflekton trendin më të ngadalësuar të rritjes së kreditimit për korporatat jofinanciare si dhe parapagimin e një pjese të kredive nga disa kreditorë të mëdhenj në kuadër të kërkesave për limitet për ekspozimet e mëdha. Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare përshpejtuan trendin e rritjes vjetore. Sipas Anketës së Kreditimit Bankar (AKB), dinamikat e kreditimit edhe në tremujorin e katërt të vitit 2023, sikurse gjatë pjesës tjetër të vitit, u ndikuan nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime marginale. Një zhvillim i tillë i karakterizuar me ngadalësim të trendit rritës në aktivitetin kreditues është në linjë me orientimin e politikës monetare të BQE-së drejt frenimit të inflacionit.


Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 9.9 përqind, për 5.8 pikë përqindje më ulët se viti paraprak (grafiku 22). Ngadalësim të rritjes së kreditimit kishte pothuajse për të gjithë sektorët ekonomik, veçanërisht në sektorët me peshë më të lartë në kreditim, siç janë ai i tregtisë, prodhimit dhe ndërtimtarisë. Ky zhvillim sugjerohet të jetë ndikuar më shumë nga faktorët e kërkesës, përderisa oferta kreditore mbeti e pandryshuar. Bankat deklaruan standarde kreditore

Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.


kryesisht të pandryshuara si për ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe për NVM-të. Derisa kishte rritje të lehtë të kërkesës për kredi nga NVM-të, kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha mbeti kryesisht e pandryshuar. Rritja më e ngadalësuar e kreditimit për ndërmarrje është në linjë me zhvillimet e përgjithshme makroekonomike, përkatësisht rritjes më të ngadalësuar të BPV-së krahasuar me një vit më parë. Kreditë për ekonomitë familjare shënuan përsheptim të rritjes vjetore në 17.3 përqind nga 16.7 përqind në vitin paraprak. Për shkak të peshës më të lartë në gjithsej kreditë, segmenti i korporatave jofinanciare kishte kontributin kryesor në ngadalësimin e përgjithshëm të aktivitetit kreditor (grafiku 23).

Kreditë e reja gjatë vitit 2023 shënuan rritje vjetore prej 9.9 përqind nga 6.5 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Segmenti i korporatave jofinanciare u karakterizua me ngadalësim të normës së rritjes vjetore të kredive të reja në 7.1 përqind nga 9.6 përqind, ndërsa ai i ekonomive familjare shënoi rritje të përsheptuar prej 14.1 përqind nga 2.4 përqind në vitin paraprak (grafiku 24). Në kuadër të KJF-ve, ngadalësim të shkallës së rritjes kishin kreditë e reja me karakter investues të cilat u rritën për 3.6 përqind nga 9.0 përqind, ndërsa kreditë me karakter jo-investues shënuan rritje të përsheptuar vjetore prej 15.6 përqind nga 7.8 përqind në vitin 2022. Në kuadër të segmentit të ekonomive familjare, kreditë e reja konsumuese shënuan rritje vjetore prej 23.2 përqind nga rënia prej 6.3 përqind që kishin në vitin 2022. Ndërsa, kreditë e reja hipotekare shënuan rënie vjetore prej 11.3 përqind nga rritja prej 13.5 përqind në vitin 2022. Investimet e huaja direkte në sektorin e patundshmërisë gjithashtu treguan tendencë rënëse në vitin 2023. Kjo, së bashku me rënien e kredive të reja hipotekare, përveç efektit të bazës së rritjes më të lartë në vitin paraprak, mund të sugjerojnë për një tendencë të rënies së investimeve të përgjithshme në patundshmëri, të ndikuar nga rritja e normave të interesit si dhe çmimeve të patundshmërive.

Struktura e kredive të sektorit të korporatave jo financiare dominohet nga sektori i tregtisë, i cili është më i kredituari ndër vite, pasuar nga ai i prodhimitarisë dhe i ndërtimitarisë të cilët janë rritur me trend më të shpejtë në vitet e fundit, duke zgjeruar gradualisht pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e sektorit bankar. Gjatë vitit 2023,


Grafik 24. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.


i korporatave jofinanciare kishte kontributin kryesor në ngadalësimin e përgjithshëm të aktivitetit kreditor (grafiku 23).

Grafik 25. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 26. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

kreditimi ndaj sektorit të tregtisë vazhdoi të kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 25), si rezultat i peshës së lartë në këtë segment si dhe rritjes vjetore prej 8.3 përqind (grafik 26).

Sektori i prodhimitarisë në vitin 2023 shënoi rritje dukshëm më të ngadalësuar vjetore prej 5.9 përqind nga 29.4 përqind në vitin 2022, kur edhe kishte peshën më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit për KJF-të, ndikuar edhe nga mbështetja nga masat subvencionuese të qeverisë në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike. Kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë gjithashtu shënoi rritje vjetore më të ulët, prej 15.9 përqind nga 25.8 përqind një vit më parë. Në ngadalësimin e kreditimit për këtë sektor mund të ketë ndikuar edhe shkalla e lartë e inflacionit në vitin 2022 - rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore që janë transmetuar në ngadalësimin e punimeve ndërtimore apo ndërprerjen e përkohshme të tyre. Sektori i bujqësisë, i cili ka pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin e sektorit bankar, u karakterizua me rritje të përsheptuar vjetore prej 25.8 përqind nga rritja prej 9.9 përqind në vitin paraprak.

Detyrimet dhe burimet vetanake


Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet nga depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur nga periudhat paraprake dhe fitimit të realizuar përgjatë vitit. Të dy këto zëra përbëjnë 92.6 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ndërsa 81.3 përqind janë vetëm depozita, që rrjedhimisht janë kategoria që përcaktojnë kahjen e aktiviteteve të sektorit bankar.

Depozitat

Depozitat shënuan rritje më të ngadalësuar prej 10.4 përqind nga 13.3 përqind sa ishte një vit më parë, që kryesisht i atribuohet ngadalësimit të rritjes së depozitave të korporatave jofinanciare në 12.6 përqind nga 18.9 përqind rritje një vit më parë. Përderisa, depozitat e ekonomive familjare përshkojnë një rritje më të qëndrueshme dhe konsistente prej 11.4 përqind në krahasim me 8.2 përqind sa ishte një vit më parë.


Vlera e stokut të depozitave në fund të vitit 2023 arriti në 6.13 miliardë euro (grafiku 27), nga të cilat 1.32 miliard euro janë të korporatave jofinanciare dhe 4.06 miliard euro janë depozita të ekonomive familjare. Rritja më e ngadalësuar e depozitave këtë vit u përcaktua nga ngadalësimi i rritjes së depozitave të korporatave financiare dhe jo-financiare si dhe rënia e depozitave të korporatave publike të cilat kanë rritur investimet në letra me vlerë që ofrojnë norma më atraktive të kthimit. Megjithatë, duhet vënë në dukje se mesatarja e rritjes vjetore përgjatë gjithë muajve të vitit ishte më e lartë këtë vit me një mesatare prej 14.0 përqind krahasuar me 10.7 përqind e vitit paraprak.

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje




Burimi: BQK.

Depozitat e korporatave publike dhe qeverisë lokale shënuan rënie, ndërsa depozitat e qeverisë qendrore shënuan rritje. Depozitat e korporatave tjera financiare, që kryesisht janë depozita të fondeve pensionale, shënuan rritje shumë më të ngadalësuar krahasuar me rritjen e lartë të një viti më parë (grafiku 28).

Depozitat e reja që nënkuptojnë vetëm depozitat e afatizuara, deri në fund të vitit arritën vlerën prej 865.4 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 11.3 përqind, që është shumë më e ulët se rritja e theksuar e vitit paraprak prej 74.3 përqind. Kjo rritje e ngadalësuar e depozitave është efekt i rritjes së lartë në vitin paraprak që ishte nxitur nga dinamikat në treg me norma të rritura të interesit dhe kampanjave atraktive nga bankat për afatizim të mjeteve (grafiku 29). Stoku i depozitave të korporatave jo-financiare në fund të vitit arriti në 1.32 miliardë euro, me rritje më të ngadalësuar se një vit më parë. Depozitat e reja nga ky segment u zvogëluan në 290.5 milionë euro nga 356.2 milionë euro një vit më parë, që përkon me rënie vjetore prej 18.4 përqind nga rritja prej 23.4 përqind një vit më parë.

Ndërsa, depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje më të lartë, me ç’rast edhe depozitat e reja u rritën me normë më të lartë prej 36.4 përqind nga rritja prej 24.0 përqind një vit më parë.

Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Normat e interesit

Rritja e normave të interesit në nivel global është përkthyer në rritje të presioneve konkurruese për të siguruar financim të qëndrueshëm. Normat e interesit në depozita u prekën në një magnitudë më të lartë se normat e interesit në kredi të reja për shkak të pozicioneve fillestare të tyre, duke qenë përgjithësisht të larta në kredi, me hapsirë të kufizuar për tu rritur tutje, dhe të ulëta në depozita. Në vitin 2023, normat e interesit në kredi të reja arritën mesataren prej 6.5%, nga 6.0% në vitin 2022. Normat e interesit në depozitat e reja u rritën në mesatarisht 2.3% gjatë vitit 2023 nga 1.7% dhe 1.3% sa ishin në vitin 2022 dhe 2021, respektivisht. Kjo bëri që hendeku në mes të mesatares vjetore të normës së interesit në kredi dhe depozita të ngushtohet lehtësisht në 4.2 përqind nga 4.3 përqind, përshkak të rritjes më të lartë të normës së interesit në depozita se në kredi.

Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK.

Megjithatë nga vendimi i fundit i Banka Qendrore Evropiane për rritje të normave të interesit në shtator 2023, ajo nuk ka rritur më tej normat bazë të interesit, politikë e cila megjithatë ka arritur të frenoj inflacionin, i cili pritët të ketë rënie graduale në vitin 2024, kurse në vitin 2025 pritjet janë që të bie në nivelin prej 2.0 përqind. Këto zhvillime në politikën monetare të BQE-së kanë ndikuar pjesërisht edhe në normat e interesit të aplikuara nga bankat vendore, të cilat megjithatë kanë filluar gradualisht të zbriten, më konkretisht normat në kredi, me pritje edhe me tej rënese. Përderisa, normat e interesit në depozita vazhdojnë të ndjekin trend rritës. Për më

teper, në anketën e fundit të realizuar me bankat, nuk pritet rritje në normat e interesit në kredi apo ndikim të tyre në ofertën dhe kërkesën kreditore.

Grafik 30a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.


Në dhjetor të 2023, norma e interesit në kredi arriti në 6.3 përqind nga 6.6 përqind sa ishte në fillim të vitit. Ndërsa norma mesatare e interesit në depozita u ngrit në 3.1 përqind nga 1.9 përqind sa ishte në fillim të vitit 2023 dhe 2.4 përqind në dhjetor 2022. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 3.2 pikë përqindje (pp) nga 3.9 pikë përqindje në dhjetor 2022 (apo 4.7 pp në janar 2023) për shkak të rritjes më të lartë të normës së interesit në depozita krahasuar me ato në kredi (grafiku 30).

Për më tepër, dinamika e normave të interesit, në dy vitet e fundit, kanë ndryshuar edhe strukturën e kredive sipas llojit të normave të interesit, veçanërisht duke u reflektuar në rritjen e pjesëmarrjes së kredive me norma variabile të interesit, që për marzhën shtesë kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor. Në vitin 2021, këto kredi përbënin 19.6 përqind të total portfolios së kredive, duke u zgjeruar në 24.1 përqind në vitin 2022 dhe 31.3 përqind në mesatare në vitin 2023. Ndërsa, në dhjetor 2023, kreditë me norma variabile përbënin 33.8 përqind të gjithsej portfolios kreditore. (grafiku 30a).

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në dhjetor 2023


qëndroi në 6.5 përqind, që është për 0.03 pikë përqindje më e ulët se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për sektorin e shërbimeve prej 6.3 përqind, ndërsa norma më e lartë mesatare e interesit ishte për sektorin e bujqësisë prej 13.1 përqind (grafiku 31).

Grafik 31. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.

Grafik 32. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare arriti në 6.2 përqind, për 0.24 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare, me një mesatare prej 5.3 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik më të ulët pasi kanë mbulesë me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit prej mesatarisht 6.4 përqind sa ishin në dhjetor 2023 (grafiku 32).

Normat e interesit në depozita filluan trendin rritës që nga muaji qershor i vitit 2022. Në dhjetor 2023, norma mesatare e interesit në depozita është rritur për 0.8 pikë përqindje, duke arritur një normë prej 3.1 përqind në dhjetor 2023. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare është rritur për 1.2 pikë përqindje, në 3.7 përqind. Normat poashtu janë rritur edhe për ekonomitë familjare për 0.6 pikë përqindje, duke arritur në 2.5 përqind në dhjetor 2023 (grafiku 33).


Performanca e sektorit bankar

Profitabiliteti i sektorit bankar u afektua theksueshëm në dy kahje nga rritja e normave të interesit, me disa banka që patën një rritje substanciale të fitimeve nga rritja e të ardhurave nga interesi në kredi, dhe të tjera që u përballën me sfida nga shpenzimet më të larta, veçanërisht atyre shpenzimeve që ndërlidhen me interesat në depozita dhe shpenzimeve administrative.

Sektori bankar në fund të vitit 2023 realizoi profit neto prej 155.9 milionë euro, që megjithatë përkon me rritje më të ngadalësuar vjetore prej 11.1 përqind krahasuar me 19.4 përqind të një viti më parë. Rezultati i tillë financiar rezulton nga rritja e të hyrave nga interesi në kredi, përderisa në frenim të rritjes së theksuar, në këto dy vite ka ndikuar rritja e lartë e shpenzimeve të interesit në depozita (që ndërlidhen me rritjen e normave të interesit) dhe shpenzimeve administrative. (grafiku 34).


Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 435.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.6 përqind nga 15.0 përqind një vit më parë. Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor e kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 74.6 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, ato në kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit dhe njëkohësisht normave të rritura të interesit në kredi në dy vitet e fundit. Për më tepër, edhe të hyrat nga letrat me vlerë kanë shënuar rritje nga rritja e investimeve në këtë kategori që ka siguruar kthime më të larta, përderisa plasmanet me bankat kanë shënuar theksueshëm ngadalësim të rritjes në raport me vitin paraprak. Kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 3.2 përqind nga rritja prej 8.0 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 95.7 milionë euro në fund të vitit.

Grafik 33. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

Grafik 34. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

Vlera e shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 279.6 milionë euro, e karakterizuar me rritje më të përshpejtuar vjetore, përkatësisht prej 21.5 përqind nga rritja prej 12.4 përqind një vit më parë. Kontributin më të lartë në këtë rritje e kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, dhe e shpenzimeve të interesit. Kategoria me peshën më të lartë në gjithsej shpenzimet, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 56.1 përqind, u rrit për 15.9 përqind nga 12.1 përqind sa kishte rritje në vitin e kaluar, dhe arritën vlerën nominale në 156.8 milionë euro në fund të vitit. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit. Tutje, shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore prej 55.4 përqind nga rritja prej 9.1 përqind në vitin paraprak, që i atribuohet rritjes së normave të interesit në të gjitha kategoritë që krijojnë shpenzime të interesit dhe njëkohësisht rritjes së stokut të depozitave. Dinamika e tillë e profitit ndikoi që edhe Kthimi në Kapital të jetë më i ulët, përkatësisht në raportin prej 19.7 përqind nga 20.6 përqind një vit më parë. Ndërsa kthimi në asete mbeti në nivelin e njëjtë prej 2.5 përqind.


Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo-performuese. Nivelet e këtyre indikatorëve përtej kërkesave rregullatore i japin përparësi sektorit në absorbimin e humbjeve të mundshme që do të shkakttoheshin në rast të goditjeve të mundshme makroekonomike dhe financiare.

Ekspozimet jo-performuese janë rritur për 12.2 përqind krahasuar me rritjen prej 4.3 përqind një vit më parë, megjithatë, raporti i kredive jo-performuese qëndroi në nivelin e njëjtë të ulët prej 2.0%, rezultat ky i rritjes së theksuar të kreditimit. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëlu në 147.2 përqind nga 151.7 përqind në vitin paraprak, kjo për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese se sa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafiku 35).

Norma e kredive jo-performuese për segmentin e ekonomive familjare vazhdon të jetë e ulët, prej 1.4 përqind në dhjetor 2023, megjithëse ky raport është rritur nga norma prej 1.2 përqind e një viti më parë për shkak të rritjes më të theksuar të ekspozimeve jo-performuese në vlerë prej 7.0 milionë euro apo 36.1 përqind, krahasuar me rritjen e kreditimit për këtë segment prej 17.5 përqind. Për segmentin e korporatave jo-financiare raporti i KJP-ve ishte 2.4 përqind nga 2.5 përqind një vit më parë për shkak të rritjes më të lartë të kreditimit ndaj këtij sektori (prej 10.4 përqind) krahasuar me rritjen vjetore të vlerës së KJP-ve prej 5.0 përqind. Me rritje të vlerës së KJP-ve u karakterizua sektori i energjisë dhe prodhimitarisë, për 3.7 milionë euro dhe 5.0


Grafik 35. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione



Burimi: BQK.

Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëlu në 147.2 përqind nga 151.7 përqind në vitin paraprak, kjo për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese se sa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafiku 35).

Grafik 36. Treguesi i solvencës




Burimi: BQK.

Me rritje të vlerës së KJP-ve u karakterizua sektori i energjisë dhe prodhimitarisë, për 3.7 milionë euro dhe 5.0

milionë euro respektivisht, kurse si raport ndaj kredive është rritur për 7.2 pikë përqindje dhe 0.8 pikë përqindje, respektivisht, duke arritur në nivelin 9.5 përqind për sektorin e energjisë dhe 2.2 përqind për atë të prodhimitarisë. Vlera e KJP-ve krahasuar me vitin 2022 për sektorin e tregtisë dhe shërbimeve u zvogëlua për 2.4 dhe 1.3 milionë euro, respektivisht, ndërsa si raport ndaj kredive zbriti në 1.9 përqind nga 2.3 përqind, dhe raporti i KJP-ve për sektorin e shërbimeve zbriti në 3.9 përqind nga 5.1 përqind. Ndërsa për sektorët e tjerë vlera dhe raporti i KJP-ve pësuan lëvizje më marginale krahasuar me vitin paraprak.

Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, është rritur lehtësisht në 15.8 përqind nga 15.5 përqind një vit më parë. Rritja në normën e kapitalizimit është ndikuar si nga rritja e profitit dhe niveli më i ulët i shpërndarjes së dividendës, ashtu edhe nga ngadalësimi i rritjes së mjeteve të peshuara me rrezik, përkatësisht aktivitetit kreditor (grafiku 36). Përkundër nivelit të lartë të **likuiditetit** dhe burimit të qëndrueshëm të financimit siç janë depozitat, rreziku i likuiditetit vazhdon të kërkojë monitorim të vazhdueshëm, duke marrë parasysh rrethanat e tregut.


Grafik 37. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Sektori dëshmoi ndryshime në strukturën e investimeve, duke sugjeruar adaptim të vazhdueshëm ndaj kushteve të reja të krijuara në treg, me rritje të kostos së financimit dhe njëkohësisht rritje të mundësive atraktive për investim. Veçanërisht është shënuar rritje e investimeve në instrumente financiare të tregjeve të huaja, përderisa investimet në letra me vlerë të qeverisë në vend kanë shënuar përgjithësisht rënie. Disa banka kanë filluar dhe të tjera kanë rritur investimet në tregjet globale, me objektivë sigurimin e likuiditetit përballë dinamikave aktuale të tregut. Kjo reflektohet edhe nga rënia, megjithëse jo e theksuar e raportit të likuiditetit për 1.8 pikë përqindje, në 34.7 përqind në dhjetor 2023 krahasuar me raportin prej 36.5 përqind një vit më parë. Rënia e lehtë e raportit i atribuohet rritjes më të theksuar të detyrimeve afatshkurta prej 10.0 përqind sesa i rritjes së mjeteve likuide prej 4.7 përqind (rezultat i zvogëlimit të balancave në llogari rrjedhëse, plasmaneve dhe depozitave në bankat vendore si dhe investimeve në obligacione qeveritare vendore) (grafiku 37). Ndërsa, raporti kredi-depozitë është rritur në 80.2 përqind nga 78.3 përqind, për shkak të rritjes më të theksuar të kreditimit se depozitimit. Treguesi i mbulimit me likuiditet qëndroi në 279.7 përqind në fund të vitit 2023 nga 228.2 përqind sa ishte në fillim të vitit 2023.

Grafik 38. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

4.2. Sektori pensional


Asetet e sektorit pensional shënuan rritje të lartë në vitin 2023 pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë. Përkundër sfidave përgjatë vitit që ndërlidhen me rritje më të ngadalësuar ekonomike, presione inflacioniste dhe tensione gjeopolitike në nivel global, të dy fondet pensionale shënuan kthim pozitiv nga investimet në tregjet e jashtme, duke përfitur nga normat e larta të interesit, dhe efekteve të politikave monetare konservative për të kontrolluar inflacionin në rritje.

Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë prej 24.4 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, asetet e fondeve pensionale shënuan rritje për 12.1 përqind në vitin 2023, krahasuar me rritjen vjetore prej vetëm 2.4 përqind një vit më parë (grafiku 38). Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.71 miliardë euro, nga të cilat 99.7 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), dhe pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja). FKPK-ja shënoi rritje vjetore të aseteve prej 12.1 përqind, ndërsa asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja) u rritën për 9.9 përqind nga viti paraprak.


Asetet FKPK-së janë të investuara kryesisht në tregun e jashtëm që përbëjnë 74.5 përqind të gjithëj portfolios investuese. Invesimet në tregun e jashtëm që kryesisht janë portfolio e fondeve të përbashkëta, janë rritur theksueshëm duke arritur vlerën 2.01 miliardë euro, ndërsa pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në tregun e brendshëm. Përderisa investimet në tregjet e jashtme janë rritur, ato në tregun vendor shënuan rënie, me përjashtim të parasë së gatshme që është bilanc i mbajtur në BQK, e cila shënoi rritje. Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në fund të vitit 2023 zbritën në 447.1 milionë euro nga 553.8 milionë euro sa ishin në fund të vitit të kaluar, apo në 16.5 përqind të gjithëj portfolios investuese nga 23.0 përqind pjesëmarrje në fund të vitit 2022. Kategoria e çertifikatave të depozitit në bankat vendore në fund të vitit 2023 zbriti në 90.1 milionë euro apo 3.3 përqind e gjithëj investimeve, nga 5.7 përqind sa ishte një vit më parë.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja në vitin 2023 shënoi rritje vjetore prej 18.5 përqind, duke arritur vlerën prej 286.2 milionë euro (grafiku 39b). Rritja e lartë dyshifrore e kontributeve të arkëtuara ndër tjerash reflekton rritjen e nivelit të pagave përfshirë përshtatjen ndaj inflacionit si dhe rritjen e pagave të shërbyesve civil në fillim të vitit 2023. Kurse, kthimi bruto në investime në vitin 2023 arriti në 87.7 milionë euro, duke rikuperuar në masë të madhe humbjet e një viti më parë në vlerë prej 118.8 milionë euro. Kthimi pozitiv në investime, veçanërisht në TM4 2023 në vlerë prej 40.1 milionë euro, u ndikua nga rritja e vlerës së aksioneve, që u ndikuan nga sinjalet e politikave monetare për të mos rritur tutje normat bazë të interesit.

Grafik 39a. Performanca e FSKP-së



Grafik 39b. Performanca e FKPK-së



Struktura e portfolios investuese e FSKP-s është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, më konkretisht në aksione që përbëjnë 77.2 përqind të portfolios investuese dhe pjesa tjetër në para të gatshme, që përbëjnë 2.4 përqind të gjithsej investimeve. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përfaqësojnë 18.0 përqind të gjithsej portfolios investuese. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend që përbëhet nga para ja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale përbëjnë 2.4 përqind të portfolios.

Për dallim nga viti i kaluar, përgjatë këtij viti edhe FKPK ka rritur investimet në tregun e jashtëm kundrejt zvogëlimit të investimeve në sektorin e brendshëm (grafiku 38a).

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja në vitin 2023 arriti në 667.0 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.6 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontributdhënësve dhe njëkohësisht nga rritja e pagave konform indeksimit me inflacion (grafik 39a). Kurse, kthimi kumulativ bruto nga investimet në vitin 2023 arriti vlerën në 817.0 mijë euro krahasuar me humbjet e një viti më parë në vlerë prej 788.6 mijë euro.

4.3. Sektori i sigurimeve


Sektori i sigurimeve me një përfaqësim prej 2.7 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar u karakterizua me rritje dyshifrore, kryesisht si rezultat i rritjes së primeve të shkruara. Për më tepër, sektori është duke performuar me kthim pozitiv financiar për të tretin vit me radhë, për dallim nga humbjet e realizuara në vitet e mëparshme. Vlera e gjithsej asetëve arriti në 304.1 milionë euro në fund të dhjetorit 2023, që paraqet një rritje vjetore prej 12.7 përqind (grafiku 40). Zgjerimi i sektorit u mundësua nga rritja e rezervave teknike, që janë rezultat i primeve të shkruara përgjatë vitit 2023, si dhe kapitalit vetanak të siguruesve.

Në kuadër të asetëve, rritje më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, kryesisht të afatizuara, të cilat janë financuar nga të hyrat nga primet e shkruara. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje të përsheptuar krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, cilësia e asetëve dhe treguesve kyç mbetet për t'u përmirësuar më tej.

Vlera e primeve të shkruara në vitin 2023 arriti në 146.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.4 përqind, e ndikuar kryesisht nga rritja e primeve të shkruara të kategorisë 'përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë' në kuadër të sigurimit të detyrueshëm, si dhe 'sigurimi i mjeteve tokësore' dhe 'sigurimi i shëndetit' në kuadër të sigurimit vullnetar. Primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më të madhe, prej 59.1 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë. Këto prime, në vlerë janë rritur për 9.7 përqind krahasuar me një vit më parë, kurse në numër (polica të shitura), janë rritur për 10.5 përqind. Vlera e primeve për 'sigurimin e shëndetit' u rrit për 6.5 përqind krahasuar me një vit më parë, kurse në numër janë rritur për 10.3 përqind. Përderisa, vlera e primeve për 'sigurimin e mjeteve tokësore' u rrit për 20.8 përqind, ndërsa në numër për 13.2 përqind krahasuar me një vit më parë. Në anën tjetër, vlera e primeve të shkruara të sigurimit 'të jetës' në vitin 2023 arriti në 6.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.5 përqind.

Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në vitin 2023 arriti në 71.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.6 përqind krahasuar me 5.4 përqind një vit më parë (grafiku 41). Vlera e dëmeve të paguara vetëm nga kompanitë e sigurimeve shënoi rritje vjetore prej 18.4


Grafik 40. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

përqind (për 10.2 milionë euro më shumë se një vit më parë), duke arritur vlerën 65.7 milionë euro në vitin 2023. Kurse vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja shënoi rënie vjetore prej 31.2 përqind, duke zbritur në 6.1 milionë euro nga 8.8 milionë euro sa ishin në vitin 2022. Rritja më e theksuar e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit rezultoi nga segmenti 'jo-jetë', përkatësisht i dëmeve të 'sigurimit nga zjarri dhe forcat e natyrës', 'përgjegjësitë motorike ndaj palës së tretë' dhe 'sigurimi i shëndetit', nga të cila kategoria e 'përgjegjësisë motorike ndaj palëve të treta' vazhdon të ketë peshën më të madhe prej 49.4 përqind të gjithsej dëmeve të paguara nga segmenti 'jo-jetë'.

Grafik 41. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Sektori i sigurimeve mbylli vitin 2023 me fitim neto në vlerë prej 10.7 milionë euro nga 2.1 milionë euro fitim një vit më parë. Fitimi më i lartë i realizuar në vitin 2023 është rrjedhojë e rritjes më të lartë të arkëtimit nga primet e shkruara në raport me rritjen më të ngadalësuar të shpenzimeve, përkatësisht 'dëmeve të ndodhura' dhe shpenzimeve operacionale (që përfshijnë shpenzimet për personelin dhe administrative). Ecuria e trajtimit, rezervimit dhe pagesës së dëmeve mbetet në fokusin e lartë të BQK-së.


4.4. Sektori mikrofinanciar

Sektori shënoi rritje të lartë të aktiviteteve të saj në vitin 2023, mbështetur kryesisht nga huamarrjet nga sektori i jashtëm për të financuar aktivitetin kreditues, duke ruajtur njëkohësisht cilësinë e portfolios kreditore dhe rritur profitabilitetin. Sektori është i ekspozuar dhe shumë më i ndjeshëm ndaj dinamikave në tregjet e jashtme për shkak të nivelit të lartë të mbështetjes së financimit në këto tregje, e që për pasojë ambienti me norma të rritura të interesit ka afektuar në nivel të lartë koston e financimit të këtyre institucioneve.

Asetet

Vlera e aseteve të sektorit mikrofinanciar arriti në 541.5 milionë euro në fund të vitit 2023, duke shënuar rritje vjetore prej 35.1 përqind (grafiku 42)⁴. Në këtë rritje kontributin kryesor e kishte rritja e kreditimit dhe në masë më të ulët rritja e lizingjeve. Aktiviteti kreditor i sektorit vazhdon të mbështetet nga huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit të cilat u rritën për 32.2 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, nga fitimi i bartur dhe atij të realizuar gjatë kësaj periudhe.

Grafik 42. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

⁴ Nga nëntor 2023 dy institucione financiare janë ri-klasifikuar nga ndihmës financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF&IFJB). Kjo ka ndikuar që të rris vlerën e aseteve në sektorin mikrofinanciar (ka ndikuar kryesisht në rritje të zërit të bilancit me bankat tjera).

Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar, ka shënuar trend rritës sërish pas vitit pandemik, me theks të veçantë në vitin 2023, vlera e të cilave arriti në 361.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 26.3 përqind. Rritja e theksuar e kreditimit nga sektori mikrofinanciar mund të jetë rezultat i kërkesës më të lartë nga qytetarët për kredi, por edhe sigurimi i fondeve nga huazimet e jashtme. Anketa e kreditimit bankar sugjeron se dinamikën e kreditimit e ka përcaktuar kryesisht kërkesa e lartë kreditore, përkundër ofertës kreditore marginalisht të ndryshuar nga bankat, dinamikë e cila mund të shpjegoj kërkesën e rritur për kredi edhe tek institucionet mikro-financiare.


Grafik 43. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.


Të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare, u karakterizuan me ecuri të ngjashme të rritjes së kreditimit, me ç'rast kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 21.3 përqind nga 16.4 përqind sa ishte në vitin 2022, duke arritur vlerën 220.8 milionë euro (grafiku 43). Stoku i kredive ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën prej 140.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 34.9 përqind nga 26.2 përqind në vitin 2022. Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare ka ndjekur trendin rritës në të gjithë sektorët ekonomik (grafiku 44). Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe prej 25.0 përqind në gjithsej portfolion e kredive ndaj korporatave jofinanciare, duke qenë sektori edhe me kontributin më të lartë në rritjen e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare (grafiku 45).

Grafik 44. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Grafik 45. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Vlera e kredive ndaj sektorit të bujqësisë arriti në 35.2 milionë euro, që përkon me rritje vjetore prej 30.7 përqind. Rritja e theksuar e kredive për sektorin e bujqësisë është mbështetur edhe nga garancionet kreditore nga Fondi i Kosovës për Garanci Kreditore.

Lizingjet


Lizingjet janë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar me një pjesëmarrje prej 17.8 përqind. Aktiviteti i lizingjeve shënoi rritje vjetore prej 30.8 përqind, kurse vlera e tyre arriti në 96.4 milionë euro (grafiku 46). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor

vazhdojnë ta kenë korporatat jofinanciare, të cilat kanë dhe peshën më të lartë prej 69.4 përqind në gjithsej lizingjet, përderisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i ulët.

Normat e Interesit


Sektori mikrofinanciar poashtu u ndikua njëtrajtshmërisht nga dinamikat e normave të interesit në nivel global, megjithëse me hapësirë më të kufizuar për rritjen tutje të normave të interesit. Norma mesatare e interesit në kreditë nga IMF-të vazhdoi të jetë e lartë 18.62 përqind, ngjashëm me periudhën e njëjtë të një viti më parë prej 18.59 përqind (grafiku 47). Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi rritje për 0.5 pikë përqindje, në 21.1 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese është rritur për 1.4 pikë përqindje në 23.8 përqind ndërsa e kredive hipotekare është zvogëluar për 1.5 pikë përqindje, në mesatare prej 15.8 përqind.

Grafik 46. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 47. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 48. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Për korporatat jo-financiare, norma mesatare e interesit u rrit për 0.5 pikë përqindje, në 15.9 përqind (grafiku 48). Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve u rritën për 0.6 dhe 1.3 pikë përqindje përkatësisht, duke arritur në 17.9 përqind dhe 15.1 përqind, respektivisht. Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë u zvogëluar në 17.0 përqind, për 0.3 pikë përqindje nga një vit më parë.

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar realizoi profit neto në vlerë prej 18.2 milionë euro, duke qenë për 7.1 përqind më i lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Kontributin në rritje të profitit e kishte rritja më e lartë e të hyrave si rezultat i rritjes së aktivitetit kreditor. Përkatësisht, të hyrat shënuan rritje vjetore prej 26.0 përqind, aporritje e vlerës për 14.6 milionë euro krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 70.7 milionë euro në fund të vitit 2023. Ndërsa, shpenzimet u rritën për 34.1 përqind, që në vlerë përkon me rritje për 13.4 milionë euro krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 52.5 milionë euro në fund të vitit 2023 (grafiku 49).


Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi që përfaqësojnë kategorinë kryesore prej 87.0 përqind, shënuan rritje vjetore prej 22.0 përqind nga 15.9 përqind sa ishin në vitin 2022, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të

kreditimit, dhe arritën vlerën prej 61.5 milionë euro në fund të vitit 2023. Kategoria e të hyrave nga jo-interesi, që përbëjnë 13.0 përqind të gjithë të hyrave, shënoi rritje vjetore prej 61.6 përqind nga 6.6 përqind një vit më parë, si rezultat i rritjes së të hyrave nga tarifat dhe komisionet në 4.4 milionë euro nga 0.9 milionë euro sa ishin në vitin e kaluar për shkak të zgjerimit të aktivitetit dhe licencës ⁵ që kontribuon në qasjen në financa dhe përfshirje financiare.

Në kuadër të shpenzimeve, kategoria e cila shënoi rritjen më të lartë ishte ajo e shpenzimeve për interesa. Kjo kategori arriti vlerën në 8.4 milionë euro në fund të vitit 2023, që përkon me rritje vjetore prej 70.8 përqind (4.6 përqind rritje një vit më parë), dhe kishte kontributin më të lartë në rritjen e përgjithshme të shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar. Rritja e theksuar e kësaj kategorie është rezultat i rritjes së shpenzimeve për interesa nga huamarrjet, që është kategori e financimit të aktivitetit kreditor të mikrofinancave. Kategoria që ka peshën më të madhe prej 52.6 përqind në shpenzimet e sektorit, ajo e shpenzimeve për jointeresa në fund të vitit 2023 arriti vlerën në 27.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore për 20.2 përqind nga 21.2 përqind një vit më parë, më e ngadalësuar për shkak të ngadalësimit më të theksuar të rritjes së shpenzimeve për personelin, përderisa shpenzimet për provizione kishin shënuar rritje. Megjithatë, sektori mikrofinanciar këtë rritje të kostos së financimit nga burimet e jashtme nuk e reflektoi tek kreditë e tyre. Burimet e financimit me kushte të favorshme dhe për rrjedhojë të përballueshme për kredimarrësin mbesin sfida kryesore e këtyre institucioneve financiare.


Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithësej kredive në fund të dhjetorit 2023 ishte 1.8 përqind, ngjashëm me një vit më parë. Megjithatë vlera e ekspozimeve jo-performuese u rrit për 20.6 përqind nga rënia prej 12.4 përqind e një viti më parë, duke arritur vlerën në 7.5 milion euro në fund të dhjetorit 2023 nga 6.2 milion sa ishte një vit më parë. Niveli i

Grafik 49. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 50. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Grafik 51. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.



⁵ Nga nëntor 2023 dy institucione financiar janë ri-klasifikuar nga ndihmës financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF&IFJB). Këto ndryshime kanë afektuar edhe pasqyrën e të ardhurave, veçanërisht nënkategorinë e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet, për shkak që këto institucione operojnë si IFJB që natyra e aktivitetit të tyre është e tillë që realizon të hyra kryesisht nga tarifat dhe komisione në shërbimet që i ofrojnë.


mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione në dhjetor 2023 u zvogëlua për 3.4 pikë përqindje, në 149.7 përqind (grafiku 50), rezultat ky i rritjes më të lartë të kredive jo-performuese se sa i rritjes së provizioneve. Për më tepër, niveli i kredive jo-performuese vazhdon të jetë më i lartë për IFJB-të kundrejt IMF-ve, por që gradualisht është zvogëluar ndër vite (grafiku 51).

4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Vlera e emetuar e borxhit përmes letrave me vlerë në ankand përgjatë vitit 2023 ishte përgjysëm më e ulët sesa shuma e emetuar në ankand përgjatë vitit paraprak.


Për dallim nga vitet paraprake, në tremujorin e katërt të këtij viti nuk është emetuar borxh shtetëror. Letrat me vlerë të emetuara gjatë vitit arritën vlerën prej 106.9 milionë euro, që është për 52.2 përqind më e ulët sesa emetimi i një viti më parë (grafiku 52). Ndërsa, kërkesa e akterëve në treg për të investuar në letra me vlerë, lehtësisht ka tejkaluar ofertën e qeverisë për 1.07 herë, përdërisa ky raport një vit më parë ishte 1.27 (grafiku 53).

Grafik 52. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 53. Shuma e ofruar dhe emetuar




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Në rënien e raportit kërkesë/ofertë ka ndikuar njëkohësisht edhe rënia e ofertës, ku janë ofertuar në ankand 40.8% më pak vlerë e letrave me vlerë, e poashtu edhe i kërkesës ku janë paraqitur në ankand 50.2% më pak kërkesë për të investuar në letra me vlerë. Mbajtësit e letrave me vlerë qeveritare udhëhiqen nga fondet pensionale që përbëjnë 46.2 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 23.6 përqind, institucionet publike 22.1 përqind dhe kompanitë e sigurimit që përbëjnë 5.1 përqind të stokut të borxhit dhe pjesa e mbetur prej 3.0 përqind mbahen nga të tjerë investitor.

Në fund të vitit 2023, stoku i borxhit të brendshëm të qeverisë së Kosovës në formë të letrave me vlerë, të mbajtur nga investuesit si bankat, fondet pensionale, institucionet publike dhe kompanitë e sigurimit kishte vlerën prej 970.19 milionë euro nga 1.11 miliard euro në vitin e kaluar. Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit ndër vite ka pësuar ndryshime graduale, duke u zgjeruar drejt afateve më të gjata të maturimit. Në periudhën janar-dhjetor 2023, struktura u dominua nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitet prej '5 vite', që përbëjnë gjysmën e letrave me vlerë të emetuar gjatë kësaj periudhe, pasuar nga ato me maturitet prej '3 vite', (grafiku 54).

Grafik 54. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 45, TM4 2023, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandevë për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: Ballina | FKPK (trusti.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu); Key ECB interest rates (europa.eu)

FAO: Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations (fao.org)

IMF (FMN): International Monetary Fund (IMF)

World Economic Outlook: World Economic Outlook (imf.org)

World Bank: Commodity Markets: Commodity Markets (www.worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org